

DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK NË SKENDERAJ

Datë : 18, Dhjetor , 2024

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

Plani I punës së Drejtorisë së prokurimit në përgjithësi duhe të jetë I harmonizuar dhe do të korrespondoj me kufijtë të buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin 2025, për të gjitha shtyllat e buxhetit, andaj Drejtoria e Prokurimit, në kuadër të autorizimeve ligjore dhe përgjegjesive të saj për vitin 2025 me autorizimin e ZKA-së do të procedojë në zhvillimin e procedurave për lidhjen e kontaktave publike për kategorite mallra dhe shërbime të cilat skadojnë përgjat vitit fiskal si dhe ato të projekteve të reja kapitale të cilat janë parapare në kuadër të buxhetit për vitin 2025 (përjashtimisht ndryshimeve të projekteve me rishikim të buxhetit dhe përcjellja e procedurave që rrjedhin nga viti paraparak)

Drejtorja e Prokurimit gjatë vitit 2025 planifikon t'i kryej këto në kuadër Njësive kërkuese të komunës së Skenderajt dhe në kuadër të Drejtorisë si vijon:

1. Përgatitja e buxhetit për vitin 2025 (korniza afatmeseme buxhetore, rrjedha e parase , përcjellja e buxhetit dhe shfrytëzimi I tij në mënyrë transparente), Përgatitja e planit të prokurimit, preliminar , përfundimtar .
2. Përgatitja e raporteve të punës (muajore, vjetore)
3. Në bashkëpunim me Njësitet kërkuese dhe ZKA (Kryetarin e Komunës) do të hartohet Plani përfundimtar i prokurimeve për vitin 2025 dhe sipas LPP-së dhe Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe do të dorëzohet në AQP
4. Do ta finalizojmë Raportin përfundimtar për kontratat e nënshkruara dhe do ta dorëzojmë në KRPP (Janar 2025).
5. Në muajin Janar / 2025 do të kryhen të gjitha procedurat për interes të Njësive kërkuese , përfshirë furnizime , shërbime , punë (kapitale), konkurse projektimi dhe procedurat tjera (të cilat janë emërgjente apo të ngjajshme) të përfshira në Planifikimin përfundimtar të Prokurimit (AQP).
6. Nga muaji Janar / 2025 do të insistohet që të fillohet me zhvillimin e procedurave , caktohen anëtarët e komisioneve në vlerësim do të ipen propozimet për anëtar të komisioneve, menaxher / mbikqyres ndërsa ZKA do ta nxjerrë Vendim dhe do ta nënshkruaj.
7. Do të hartohet një Listë e anëtarëve të komisioneve për hapje të tenderëve, të cilët do të marrin pjesë në hapje të ofertave.
8. Sipas Planit Preliminar të prokurimeve gjatë vitit 2025 do të publikohen të gjitha procedurat e inicuar nga Njësitet kërkuese, për Furnizime, Shërbime dhe Punë (projekte kapitale)
9. Publikimi i tenderëve do të bëhet konform Planit të prokurimeve si dhe kërkesave që vijnë nga Njësitet kërkuese.

10. Gjatë vitit 2025 Drejtoria e Prokurimit llogaritë që për nevojat e Njësive kërkuese t'i kryej të gjitha procedurat pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë apo me negociata (aneks kontrata),kuotime qmimesh dhe vlera minimale varesisht prej nevojës.
11. Gjatë vitit 2025 Zyra e Prokurimit do të hartoj raporte javore, mujore dhe Tremujore, Raportetet tremujore do të dorëzohen tek Zyra e Kryetarit dhe në KRPP.
12. Gjatë vitit 2025 Zyra e Prokurimit do të insistoj që të gjitha kushtet dhe kriteret do të hartohen konform LPP - së dhe në bashkëpunim me Njësitë kërkuese.
13. Gjatë vitit 2025 do të insistohet që kërkesat fillestare ,ZP do të pranoj vetëm kërkesa për të cilat do të zhvillohen procedurat e prokurimit të cilat janë të përfshira në Planifikimin përfundimtar të prokurimit dhe punë të tjera që obligon LPP , Rregullorja ,Udhëzusi dhe legjislacioni në fuqi.

Drejtoria e Prokurimit publik për vitin 2025 do të jetë e përkushtuar që të rris transparencën dhe llogaridhënjen ,zhvillimi i kapaciteteve të personelit , përdorimi efikas i buxhetit, menaxhimi i ankesave dhe qasje transparente për të gjitha palet e interesit dhe ligjeve në fuqi.

Drejtoria e Prokurimit :

Haxhi Bejta:

